Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

Universiteti i Tiranës

UNIVERSITETI I MJEKSISË TIRANË
FAKULTETI I MJEKSISË

FAKULTETI I EKONOMISË
Universiteti i Tiranës

PROGRAM STUDIMI

MASTER PROFESIONAL NË MENAXHIM SHËNDETËSOR

2022

Me mbështetjen e:

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

HAP
health for all project

Program studimi

MASTER PROFESIONAL
NË MENAXHIM SHËNDETËSOR

Përmbajtja

Përmbledhja e programit 5

Pse është i nevojshëm ky program? 5

Qëllimi i programit "Master Profesional në Menaxhim Shëndetësor" 5

Përfitimet që sjell programi 6

Përmbajtja e programit 6

Organizimi i programit 7

Vlerësimi i studentit 7

Stafi akademik në programin "Master Profesional në Menaxhim Shëndetësor" 8

Programi i studimit 9

Lënda 1: Ekonomi shëndeti 9

Lënda 2: Menaxhim Shëndetësor 11

Lënda 3: Statistikë 13

Lënda 4: Financa dhe kontabiliteti i kujdesit shëndetësor 14
4.1. Financa në kujdesin shëndetësor 14
4.2. Kontabiliteti në kujdesin shëndetësor 16

Lënda 5: Përcaktorët socialë dhe mjedisorë të shëndetit 18
5.1. Shëndeti mjedisor 18
5.2. Përcaktorët socialë dhe të sjelljes të lidhur me shëndetin 20

Lënda 6: Epidemiologji manaxheriale 22

Lënda 7: Menaxhimi i sistemeve të informacionit & monitorim-vlerësimi 23
7.1. Menaxhimi i sistemeve të informacionit në shëndetësi 23
7.2. Monitorim-vlerësimi në shëndetësi 25

Lënda 8: Lidership dhe aftësi komunikimi 26
8.1. Lidership 26
8.2. Aftësi Komunikimi 28

Lënda 9: Organizimi i sistemit shëndetësor 29

Lënda 10: Menaxhimi i burimeve njerëzore 30

Lënda 11: Praktikë 31

Aneksi 1: Plani mësimor i programit të studimit "Master Profesional në Menaxhim Shëndetësor" 32

Përmbledhja e programit

Programi "Master Profesional në Menaxhim Shëndetësor" ofrohet nga një bashkëpunim i ngushtë midis dy Universiteteve:Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, (nëpërmjet Departamentit të Shëndetit Publik në Fakultetin e Mjekësisë) dhe Universitetit të Tiranës (nëpërmjet Departamentit të Menaxhimit në Fakultetin e Ekonomisë). Diploma lëshohet nga Fakulteti i Mjekësisë.

Pse është i nevojshëm ky program?

Ky program i ofruar nga bashkëpunimi i 2 universiteteve publike përbën një eksperiencëunike për të marrë edukim në fushën e menaxhimit të organizatave të kujdesit shëndetësor për profesionistët shëndetësorë dhe jo, që kanë rol drejtues në organizata shëndetësoredhe për ata që aspirojnë të kenë këtë rol në të ardhmen. Mjedisi i kujdesit shëndetësor është duke u bërë gjithnjë e më tepër konkurues dhe kompleks lidhur me çështjet e financimit dhe menaxhimit. Nga ana tjetër, ofruesit e kujdesit shëndetësor përveç menaxhimit të pacientëve, aktualisht janë të përfshirë gjithnjë e më shumë edhe në çështjet e menaxhimit të burimeve të sistemit shëndetësor të tilla si njerëzore, finaciare, të informacionit, të infrastrukturës dhe teknologjisë mjekësore. Në këto kushte, nevoja që sistemi universitar publik të ofrojë në mënyrë sistematike një kurs masteri profesional në fushën e menaxhimit shëndetësor është bërë kritike.

Qëllimi i programit "Master Profesional në Menaxhim Shëndetësor"

Ky program studimi synon zhvillimin dhe/ose forcimin e kapacitetevenë menaxhim, planifikim dhe administrim të organizatave të kujdesit shëndetësor të të gjitha niveleve të sistemit shëndetësor. Ai ofrohet për të gjithë profesionistët që janë pjesë e strukturave drejtuese dhe ose menaxhuese të organizatave të kujdesit shëndetësor ose që aspirojnë të punojnë në pozicione të tilla, me qëllim për t'i aftësuar më tej ose bërë gati për një menaxhim më efektiv të organizatave të kujdesit shëndetësor.

Përfitimet
që sjell programi

• Aftësi lidershipi dhe rritje e bashkëpunimit efektiv në mjediset e organizatave shëndetësore.

• Kuptim i thelluar i faktorëve që shkaktojnë disfunksionimin organizativ, cilët faktorë mund të parandalohen, si mund të neutralizohen dhe minimizohen ato.

• Zotërim i fjalorit dhe zhvillim i aftësive menaxhuese të organizatës shëndetësore, që në pjesën më të madhe janë të zbatueshme për menaxhimin e çdo lloj struktureshëndetësore.

• Zhvillim dhe rritje profesionale përmes një ndërveprimi të ngushtë midis pedagogëve dhe kolegëve.

Përmbajtja
e programit

Plani mësimor i programit "Master Profesional në Menaxhim Shëndetësor" është i përbërë nga 11 lëndë (të cilat përfshijnë 14 module) dhe teza finale, të përshkruara si më poshtë:

1. Ekonomi shëndeti
2. Menaxhim shëndetësor
3. Statistikë
4. Financë dhe kontabilitet i kujdesit shëndetësor
4.1. Financë në kujdes shëndetësor
4.2. Kontabilitet në kujdes shëndetësor
5. Përcaktorët socialë dhe mjedisorë të shëndetit
5.1. Shëndeti mjedisor
5.2. Përcaktorët socialë dhe të sjelljes të lidhur me shëndetin
6. Epidemiologji manaxheriale
7. Menaxhim i sistemeve të informacionit në shëndetësi & monitorimi
7.1. Menaxhim i sistemeve të informacionit në shëndetësi
7.2. Monitorimi dhe vlerësimi
8. Lidership dhe aftësi komunikimi dhe vlerësimi
8.1. Lidership
8.2. Aftësi komunikimi
9. Organizim i sistemit shëndetësor
10. Menaxhim i burimeve njerëzore
11. Praktikë

Plani mësimor paraqitet në mënyrë më të detajuar në Aneksin 1.

Organizimi i programit

Ky program studimi është me kohë të plotë dhe zgjat një vit akademik (dy semestra). Viti i parë akademik i organizimit të këtij programi ishte 2017-2018.

Nga viti akademik 2021-2022 programi përfshin si lëndë më vete "Praktikën".

Kjo lëndë në thelb përfaqëson një proces shumë dinamik, bashkëpunues dhe angazhues, ku studentët do të mësojnë duke aplikuar në praktikën prej 4 javësh (100 orë) në një organizatë shëndetësore të përzgjedhur nga ana e tyre.

Numri total i ECTS është 60 ose 1500 orë mësimore pune nga ana e studentëve. Mësimi zhvillohet çdo ditë, në mjediset e Departamentit të Shëndetit Publik, nëFakultetin e Mjekësisë dhe në mjediset e Fakultetit të Ekonomisë, sipas orarit të paracaktuar më parë nga sekretaria mësimore.

Studentët pajisen me materiale mësimore të punuara nga pedagogu i lëndës, të cilat përmbajnë:

- Prezantim të leksionit në Power Point
- Përmbledhje të leksionit në shqip
- Materiale plotësuese të përkthyera në gjuhën shqipe, që i mundësojnë studentit më shumë informacion mbi çështjen e trajtuar gjatë mësimit
- Materiale origjinale në gjuhë të huaj (kapituj librash, artikuj shkencorë, etj.)

Vlerësimi i studentit

Format dhe kriteret e vlerësimit të studentit përcaktohen në planin mësimor dhe në programin e lëndës që iu bëhen të ditura studentëve. Vlerësimi për secilën lëndë mësimore kryhet pas përfundimit të saj. Nëse lënda përmban më shumë se një modul, nota e saj do të llogaritet nga mesatarja e ponderuar, e cila merr në konsideratë kreditet respektive për çdo modul.

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash. Nota më e vogël kaluese është 5 (pesë).

Stafi akademik në programin "Master Profesional nëMenaxhim Shëndetësor"

Programi "Master Profesional në Menaxhim Shëndetësor" drejtohet nga Departamentii Shëndetit Publik në Fakultetin e Mjekësisë, dhe nga Departamenti i Menaxhimit n ëFakultetin e Ekonomisë.

Koordinatorë të programit

1. Prof. Gentiana Qirjako
2. Prof. Asc. Dr. Etleva Leskaj

Stafi akademik i programit:

Fakulteti i Mjekësisë

1. Prof. Enver Roshi	Epidemiologji Menaxheriale
2. Prof. Gentiana Qirjako	Përcaktuesit socialë dhe të sjelljes në shëndet
3. Prof. Asc. Loreta Kuneshka	Përcaktuesit socialë dhe të sjelljes në shëndet
4. Prof. Asc. Alban Ylli	Përcaktuesit socialë dhe të sjelljes në shëndet
5. Prof. Asc. Jolanda Hyska	Shëndet mjedisor
6. Prof. Bajram Hysa	Ekonomi shëndeti
7. Prof. Asc. Qamil Dika	Organizim i sistemit shëndetësor
8. Prof. Asc. Adriatik Gabrani	Menaxhim shëndetësor
9. Prof. Asc. Ervin Toçi	Praktikë

Fakulteti i Ekonomisë

10. Dr. Fatma Jaupi	Aftësi Komunikimi
11. Prof. Asoc. Dr. Dorina Kripa	Financa në Kujdesin Shëndetësor
12. Msc. Viron Zaçe	Kontabilitet në Kujdesin Shëndetësor
13. Prof. Kozeta Sevrani	Menaxhimi i Sistemeve te informacionit
14. Prof. Asoc. Dr. Nevila Baci	Menaxhimi i Sistemeve te informacionit
15. Dr. Martin Serreqi	Manaxhim i Burimeve Njerëzore
16. Dr. Petrit Dollani	Monitorim dhe Vlerësimi
17. Prof. Dr. Valentina Sina	Statistikë
18. Dr. Gentian Shaqiri	Lidership
19. Prof. Asoc. Dr. Arjan Qefalia	Manaxhim Shëndetësor

Programi i “Master Profesional në Menaxhim Shëndetësor”

Lënda 1: Ekonomi shëndeti

Pedagogu: Prof. Bajram Hysa

Nr. ECTS: 5 (pesë)

Përshkrimi i lëndës

Ky modul prezanton konceptet e ofertës dhe kërkesës dhe marketet e tyre të ndërveprimit,dhe përshkruan rëndësinë e tregjeve dhe çështjeve të barazisë në kujdesin shëndetësordhe promovimin e shëndetit të mirë. Moduli ofron përshkrime të përparësive dhedisavantazheve të qasjeve të ndryshme për financimin e shërbimeve shëndetësore dheofruesve të pagesave. Studentët gjithashtu do të prezantohen me metodat kryesore tëvlerësimit ekonomik (kosto-efektiviteti dhe analiza kosto-përfitim) dhe do të ofrohen shembuj të aplikimit të tyre të mundshëm në vendimmarrjen e kujdesit shëndetësor. Dukepërdorur një qasje të aplikuar, moduli synon të ofrojë njohuri themelore të mjaftueshmepër të kuptuar kontributin kryesor të ekonomisë shëndetësore. Moduli gjithashtu siguronbazën për module të avancuara të studimeve ekonomike në shëndetësi, për studentët tëcilët janë të interesuar për njohuri më të thella.

Objektivat e lëndës

Objektivat e këtij moduli janë:

- T’u paraqesë studentëve konceptet dhe metodat e ekonomisë shëndetësore lidhur me politikat, planifikimin dhe financimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor.
- T’u mundësojë studentëve vlerësimin e aspekteve sasiore të efektivitetit dhe analizës së kostos së shërbimeve dhe rishikimeve sistematike.

Rezultatet e pritshme

Pas përfundimit të këtij moduli, studentët do të jenë në gjendje:

- Të kenë një kuptim të teknikave ekonomike që zakonisht përdoren në sistemet shëndetësore.
- Të kenë njohuri rreth modeleve dhe metodave për të vlerësuar efektivitetin, kosto-efektivitetin, kosto-përfitimin dhe kosto-dobinë.
- Të kenë njohuri rreth metodave për rishikimin sistematik dhe përzgjedhjen e praktikavemë të mira.
- Të shpjegojnë konceptet themelore të financimit të shëndetësisë dhe zbatimin e tyre në mjediset e vendeve me të ardhura të ulëta dhe të mesme.

• Të përshkruajnë dhe vlerësojnë sistemet e financimit të shëndetësisë në vendet me të ardhura të ulëta ose të mesme.
• Të kuptojnë aspektet sasiore të efektivitetit, efektivitetit të kostos dhe analizës së kostos së shërbimeve dhe të rishikimeve sistematike.
• Të kuptojnë vështirësitë dhe grackat në hulumtimet ndërkombëtare dhe ndër-rajonale.
• Të jenë në gjendje të zbatojnë konceptet, modelet dhe metodat e benchmarking.
• Të reflektojnë në mënyrë kritike marrëdhëniet mes shëndetit dhe zhvillimit ekonomik.
• Të komunikojnë në mënyrë profesionale me hulumtuesit, ekspertët e shëndetësisë dhe politikbërësit, në lidhje me çështjet e ekonomisë shëndetësore.

Lënda 2: Menaxhim Shëndetësor

Pedagogët: Prof. Asc. Dr. Arjan Qefalia
Prof. Asc. Adriatik Gabrani

Nr. ECTS: 6 (gjashtë)

Përshkrimi i lëndës

Lënda e Manaxhimit shëndetësor u jep studentëve konceptet dhe njohuritë themelore të manaxhimit modern, në epokën e globalizimit dhe në kushtet e një tregu global. Lënda ka për qëllim te trajtojë mënyrën se si një kompani/institucion drejtohet dhe se si ndikon kjo në marrëdhëniet midis aktorëve të tjerë organizativë. Kjo lëndë studion funksionin dhe impaktin e manaxhimit në organizatë, si dhe në vlerësimin e efektivitetit dhe arritjen e objektivave. Nëpërmjet kësaj lënde studentët do të njohin funksionet manaxheriale si edheaplikimin e tyre në praktikën e punës manaxheriale në organizatën apo institucionin e shëndetit si spitale, qendra trajtimi mjekësor apo institucione publike.

Ky kurs i ri është projektuar për studentët e programit master në manaxhim shëndetësor,duke përfshirë studentët e diplomuar, stazhierët, drejtuesit aktualë ose të ardhshëm, sidhe aktorë të tjerë me interes të përgjithshëm në manaxhimin në sektorin shëndetesor duke pasur parasysh specifikat, por duke synuar aplikimin e parimeve të manaxhimit në sektorin privat. Përvoja në punë përbën një avantazh por pavarësisht nga kjo syllabusi është hartuar të jetë i asimilueshëm edhe nga ata studentë që kanë background të ndryshëm nga ai ekonomik. Sesionet e orëve do të jetë një kombinim i prezantimeve/leksioneve,çështjes dhe diskutimit të temave dhe shpjegimeve të synuara për demonstrimin në sensin praktik. Gjatë të gjithë kursit, do të fokusohemi në vlerësimin e efektivitetit të rolevedhe përgjegjësive të manaxherit, të funksioneve manaxheriale si organizim, planifikim,motivim dhe kontroll duke kuptuar avantazhet dhe disavantazhet, duke njohur implikime të sjelljeve dhe veprimeve dhe duke zhvilluar aftësitë për trajtimin e situatave të vështira gjatë manaxhimit. Manaxhimi është shkencë dhe art dhe si i tillë kërkon kombinim të formimit akademik me situatat dhe rastet studimit të cilat do të jenë pjesë e përhershme e punës në auditor.

Objektivat e lëndës

Objektivat kryesore të kursit janë:

- Të pajisë studentët me njohuritë bazë mbi rolet dhe funksionet e një manaxheri në një organizatë apo institucioni publik
- Të analizojë në mënyrë të detajuar mjedisin në të cilin operojnë organizatat me qëllim që vendimet manaxheriale të jenë me një nivel të lartë efektiviteti manaxherial.

- Të orientojë studentët që të dinë të përdorin në mënyrë racionale teknikat ndihmëse në funksion të përmirësimit të cilësisë së manaxhimit.
- Ta aftësojë studentin që njohuritë e fituara gjatë këtij kursi t'i përdore në funksion të formimit të tij dhe njëkohësisht të orientohet me sukses në praktikat e punës manaxheriale

Rezultatet e pritshme

Në përfundim të studimit të kësaj lënde studenti duhet të jetë në gjendje :

- të kete përvetësuar konceptet baze të manaxhimit
- të përdorë aspekte të teorisë së manaxhimit sipas specifikave të mjedisit në fushën e shendetit
- të realizojë praktikisht motivim të diferencuar të stafit në mjedisin e punës
- të dijë të aplikojë në praktikën e punës manaxheriale funsionet bazë dhe rolet e manaxherit në përputhje me kërkesat dhe sfidat që parashtrojnë institucionet e shëndetit publik dhe mjedisi në këtë fushë.
- të realizojë analiza kritike të problemeve dhe sfidave bashkëkohore menaxheriale
- të-përmirësojë aftësitë e prezantimit të punëve individuale dhe në grup
- të realizojë komunikimin si lider në relacion me pasuesit dhe jo si manaxher me vartësit

Lënda 3: Statistikë

Pedagogët: Prof. Asc. Loreta Kuneshka
Prof. Dr. Valentina Sina
Nr. ECTS: 5 (pesë)

Përshkrimi i lëndës

Lënda synon të pajisë studentët me formimin e duhur statistikor për të kuptuar, analizuardhe për të marrë vendimet e duhura në menaxhimin e një prej sektorëve më jetikë të realitetit, siç është ai i kujdesit shëndetësor. Njohuritë që studentët do të marrin në këtë modul, do t'u shërbejnë si guidë për të ndërmarrë vendime në fushën e menaxhimit shëndetësor, të bazuara në metoda dhe teknika shkencore statistikore.
Temat e këtij moduli do të adresojnë koncepte dhe procedura të përshtatshme për aplikimin e metodave dhe teknikave të ndryshme statistikore. Kjo do të pasohet nga aplikimi ikëtyre metodave në problemet reale të menaxhimit ekonomik dhe social të sektorit të shëndetësisë.

Objektivat e lëndës

Objektivat e këtij moduli janë:

- Të kuptohet rëndësia e statistikës në fushën e menaxhimit.
- Të pajisen studentët me njohuritë e duhura, si të mbledhin, organizojnë, përpunojnë, analizojnëdhe të interpretojnë të dhënat.
- Të zhvillohen aftësitë e studentëve për të identifikuar teknikat e duhura statistikore për analizën e të dhënave.
- Të përdoret një program kompjuterik (SPSS) për analizën e të dhënave.
- Të kuptohet, ku, kur dhe si do të aplikohet metoda e përshtatshme statistikore në situata të ndryshme vendimmarrjeje menaxhuese në biznes, ekonomi dhe në sektorin e shëndetësisë.

Rezultatet e pritshme

Në përfundim të këtij kursi, pritet të jetë realizuar:

- Aftësimi i studentëve për të përdorur shifrat dhe faktet në procesin e analizës dhe të vendimmarrjes.
- Aftësimi i studentëve për të ndërtuar dhe realizuar një pyetësor gjatë një proces vrojtimi.
- Aftësimi i studentëve për të përdorur programin kompjuterik SPSS.
- Aftësimi i studentëve për të realizuar zgjedhjen e duhur në popullatë në cilësi dhe në madhësi.
- Aftësimi i studentëve për të përdorur një bazë të dhënash statistikore, dhe për të përzgjedhur treguesit e duhur për të argumentuar analizat statistikore.
- Aftësimi i studentëve për një paraqitje të drejtë dhe lehtësisht të kuptueshme të treguesve dhe metodave të ndryshme statistikore.
- Aftësimi i studentëve për të testuar hipoteza dhe për të marrë vendime efiçente menaxhuese.
- Aftësimi i studentëve për të kuptuar lidhjen mes variablave dhe për të menaxhuar me sukses bashkëveprimin e faktorëve mbështetur në teknika shkencore statistikore.

Lënda 4: Financa dhe kontabiliteti i kujdesit shëndetësor

Moduli 4.1 Financa në kujdes shëndetësor

Pedagogu: Prof. Asc. Dr. Dorina Kripa

Nr. ECTS: 2.5

Përshkrimi i modulit

Ky modul synon të pajisë studentët me formimin e duhur financiar për të kuptuar, analizuar dhe për të marrë vendimet e duhura në menaxhimin e një prej sektorëve më jetik të realitetit, siç është ai i kujdesit shëndetësor. Lënda synon të pajisë studentët me njohuri të përgjithshme mbi teknikat dhe mjetet me të përdorura përmenaxhimin financiar të kujdesit shëndetësor, menaxhimin e parave, njohjen eanalizën e pasqyrave financiare,investimet kapitale, përcaktimin e kostove dhe përdorimine informacionit të kostove përvendimmarrje, buxhetimin dhe matjen e performancës, vendosjen e çmimeve në sektorin e shëndetësisë, etj.
Njohuritë që studentët do të marrin në këtë modul, do t'u shërbejnë si guidë për të ndërmarrë vendime në fushën e menaxhimit shëndetësor, të bazuara në metoda dheteknika shkencore të financës e të kontabilitetit. Temat e këtij moduli do të adresojnë koncepte dhe procedura të përshtatshme për aplikimin e metodave dhe teknikave të ndryshme të financës. Kjo do të pasohet nga aplikimi i këtyre metodave në problemet reale të menaxhimit ekonomik dhe social të sektorit të shëndetësisë.
Lënda ka një ndërthurje të aspekteve teorike me ato praktike, duke bërë që të rritet aftësia e studentëve për një përdorim efikas të njohurive të marra në fushën e financës dhe të kontabilitetit.

Objektivat e modulit

- Të kuptohet rëndësia e menaxhimit financiar në sektorin e kujdesit shëndetësor.
- Të pajisen studentët me njohuritë e duhura lidhur me ndërtimin e pasqyrave financiare në sektorin e kujdesit shëndetësor, me identifikimin e teknikave të duhura të kontabilitetit të transaksioneve në sektorin e kujdesit shëndetësor.
- Të zhvillohen aftësitë e studentëve për të përcaktuar vlerën në kohë të parasë dhe vendimmarrjen për investime.
- Të njohin teknikat bashkëkohore të analizës së pasqyrave financiare si: analiza e raporteve financiare të likuiditetit, aftësisë paguese e të përfitueshmërisë.
- Të kuptohet sesi duhet të jetë cikli operativ dhe kapitali punues i sektorit të kujdesit shëndetësor, dhe sesi duhet të menaxhohet paraja në këtë sektor.
- Të aftësohen për të kuptuar mënyrat e financimit të kapitalit, etj.

Rezultatet e pritshme

Në përfundim të këtij kursi, pritet të jetë realizuar:

- Aftësimi i studentëve për të kuptuar problemet e menaxhimit financiar të sektorit të kujdesit shëndetësor.
- Aftësimi i studentëve për të evidentuar transaksionet e një njësie të sektorit të kujdesit shëndetësor dhe për të ndërtuar pasqyrat financiare të këtij sektori.
- Aftësimi i studentëve për të përdorur konceptet e vlerës në kohë të parasë në vendimmarrje të këtij sektori.
- Aftësimi i studentëve për të realizuar analizën e pasqyrave financiare duke përdorur metodat bashkëkohore.
- Aftësimi i studentëve për të kuptuar e përdorur mënyrat e financimit të kapitalit.
- Aftësimi i studentëve për përdorimin e informacionit të kostove për vendimmarrje specifike.

Lënda 4: Financa dhe kontabiliteti i kujdesit shëndetësor

Moduli 4.2 Kontabiliteti në kujdes shëndetësor

Pedagogu: Msc.Viron Zace

Nr. ECTS: 2.5

Përshkrimi i modulit

Ku modul synon të pajisë studentët me formimin e duhur kontabël për të kuptuar, analizuar dhe për të marrë vendimet e duhura në menaxhimin e një prej sektorëve më jetik të realitetit, siç është ai i kujdesit shëndetësor. Lënda synon të pajisë studentët me njohuritëpërgjithëshme mbi teknikat dhe mjetet me te përdorëshme për mbajtjen e regjistrimeve kontabël, për sistemin kontabel me te pershtatshem per sektorin, për njohjen e analizën e pasqyrave financiare, përcaktimin e kostove dhe përdorimin einformacionit të kostove për vendimmarrje; buxhetimin dhe matjen e performancës, në sektorin e shëndetësisë.
Njohuritë që studentët do të marrin në këtë modul, do t'u shërbejnë si guidë për të ndërmarrë vendime në fushën e menaxhimit shëndetësor.
Temat e këtij moduli do të adresojnë koncepte dhe procedura të përshtatshme për aplikimin e metodave dhe teknikave të ndryshme te kontabilitetit dhe analizes financiare. Kjo do të pasohet nga aplikimi i këtyre metodave ndaj problemeve reale të menaxhimit ekonomik dhe social të sektorit të shëndetësisë.

Objektivat e këtij moduli janë:

- Të kuptohet rëndësia e kontabilitetit në sektorin e kujdesit shëndetësor.
- Të pajisen studentët me njohuritë e duhura lidhur me mbajtjen e kontabilitetit të këtij sektori.
- Të pajisen studentet me njohuritë e nevojshme për ndërtimin e pasqyrave financiare në sektorin shëndetësor
- Të aftësojë studentët për të zbatuar konceptet teorike në raste studimore praktike

Rezultatet e pritshme

Në përfundim të këtij kursi, pritet të jetë realizuar:

• Aftësimi i studentëve për të perdorur koncepte te kontabilitetit financiar të sektorit të kujdesit shëndetësor e per t'i perdorur shifrat dhe faktet ne procesin e analizes dhe të vendimmarrjes
• Aftësimi i studentëve për të zbatuar parimet dhe praktikat e kontabilitetit të sektorit të kujdesit shëndetësor
• Aftësimi i studentëve për të ndërtuar pasqyrat financiare të sektorit të kujdesit shëndetësor sipas standarteve nderkombetare te raportimit financiar
•Aftësimi i studentëve për të përdorur pasqyrat financiare dhe për të zhvilluar ata vetë analizën e pasqyrave financiare
• Aftësimi i studentëve për një paraqitje të drejtë dhe lehtësisht të kuptueshme të treguesve dhe metodave të ndryshme te analizes financiare, duke iu referuar analizes se likuiditetit, te aftesise paguese, te treguesve te kthimit ne kapitalin e investuar.
• Aftësimi i studentëve për të perdorur informacionin e kostove për marrjen e vendimeve specifike.
• Aftësimi i studentëve për të kuptuar e zbatuar procesin e buxhetimit.
• Aftësimi i studentëve për të kuptuar e zbatuar me raste studimore kontabilitetin e përgjegjësisë
• Aftësimi i studentëve me përdorimin e metodave të kostove. Metoda ABC në sektorin e shëndetësisë.

Lënda 5: Përcaktorët socialë dhe mjedisorë të shëndetit

Moduli 5.1. Shëndeti mjedisor

Pedagogu: Prof. Asc. Jolanda Hyska

Nr. ECTS: 3 (tre)

Përshkrimi i modulit

Shëndeti mjedisor është dega e shëndetit publik që ka të bëjë me të gjitha aspektet emjedisit natyror dhe të ndërtuar që mund të ndikojnë në shëndetin e njeriut. Ajo "... trajtontë gjithë faktorët fizikë, kimikë dhe biologjikë të jashtëm të një personi, dhe të gjithë faktorëte lidhur me sjelljet që përfshijnë vlerësimin dhe kontrollin e atyre faktorëve mjedisorë që mund të ndikojnë potencialisht në shëndet" (OBSH 2016)

Ky kurs jep një pasqyrë të disa prej sfidave më të rëndësishme dhe aktuale të shëndetit tënjeriut nga faktorët e rrezikut mjedisor dhe profesional, dhe mëson njohuritë themeloredhe aftësitë ndërdisiplinore të përdorura për të vlerësuar, kontrolluar dhe parandaluar ato.Studentët do të trajtojnë kërcënimet specifike dhe do të paraqesin edhe kërcënime të rejamjedisore. Vëmendje do t'i kushtohet edhe kuptimit të modeleve të sëmundjes, llojevetë rrezikut dhe klasifikimeve, rrugëve të ekspozimit, vlerësimit të rrezikut dhe kornizave legjislative dhe institucionale për rregullim.

Objektivat e modulit

Ky modul synon të rrisë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet në shëndetin mjedisor, nëpërmjet:

- Përvetësimit të njohurive bazë mbi metodat e ndryshme të aplikuara në fushën e shëndetit mjedisor.
- Kuptimit të rëndësisë së ekspozimit ndaj rrezikut mjedisor në pasojat rrjedhëse me efekte negative për shëndetin e njeriut, përveç efekteve negative në mjedis.
- Aftësimit për të njohur dhe identifikuar agjentët kryesorë mjedisorë të lidhur me ajrin, ujin, ushqimin dhe vendbanimin; mekanizmat me të cilat këta agjentë ndërveprojnë me sistemet biologjike dhe ushtrojnë efekte negative të shëndetit.
- Aftësimit për të identifikuar dhe përcaktuar hapat në procesin e vlerësimit të rrezikut, dhe për të përshkruar menaxhimin e rrezikut nën një qasje shumëdisiplinare.

Rezultatet e pritshme

Pas përfundimit të këtij moduli, studentët do të jenë në gjendje:

- Të shpjegojnë se çfarë është shëndeti mjedisor, lidhja me shkencat e tjera shëndetësore.
- Të identifikojnë rreziqet mjedisore dhe të përshkruajnë rrugët me të cilat njerëzit janë të ekspozuar ndaj këtyre agjentëve.
- Të përshkruajnë kategoritë kryesore të përcaktorëve të shëndetit mjedisor që ndikojnë në shëndetin e popullatës.
- Të identifikojnë çështje të shëndetit mjedisor specifik për popullatën e ndjeshme dhe të prekshme.
- Të njohin shoqërimin e efekteve negative të shëndetit me stresorët e zakonshëm mjedisorë të mjedisit.

- Të shpjegojnë mekanizmat e përgjithshme të toksicitetit në nxjerrjen e një përgjigjeje toksike ndaj ekspozimeve të ndryshme mjedisore.
- Të shpjegojnë metodat aktuale të vlerësimit të rrezikut mjedisor.
- Të përshkruajnë mënyrat për vlerësimin, parandalimin dhe menaxhimin e rreziqeve mjedisore që paraqesin rrezik për shëndetin dhe sigurinë njerëzore.
- Të identifikojnë se si rreziku i perceptuar ndikon në qasjet e përdorura për të menaxhuar rreziqet e shëndetit mjedisor.
- Të përshkruajnë çështje të ndryshme mjedisore, si dhe të japin mendime të vlefshme për menaxhimin e rreziqeve.

Lënda 5: Përcakorët socialë dhe mjedisorë të shëndetit

Moduli 5.2: Përcaktorët socialë dhe të sjelljes të lidhur me shëndetin

Pedagogët: Prof. Gentiana Qirjako
Prof. Asc. Alban Ylli
Prof. Asc. Loreta Kuneshka

Nr. ECTS: 3 (tre)

Përshkrimi i modulit:

Gjatë këtij kursi, studentët do të eksplorojnë mbi përcaktorët shoqërorë dhe ato të sjelljes së lidhur me shëndetin, dhe do të analizojnë domethënien e tyre për profesionistët e shëndetit publik në mjediset e komunitetit vendas dhe ndërkombëtar.

Përcaktorët socialë të shëndetit janë kushtet shoqërore, faktorët dhe sistemet që i vendosin njerëzit nga grupe të ndryshme sociodemografike dhe socioekonomike (klasa sociale, gjinia, raca /etnia dhe vendi i lindjes) në rrezik të diferencuar të shëndetit të dobët dhe vdekshmërisë së parakohshme.

Përcaktorët e sjelljes së lidhur me shëndetin janë sjelljet njerëzore që ndikojnë në rrezikun e marrjes së sëmundjeve dhe përjetimin e shëndetit të dobët.

Objektivat e modulit

Qëllimi i këtij moduli është të sigurojë një pasqyrë të teorive dhe parimeve që mund të përdoren për të shpjeguar se si faktorët socialë dhe sjelljet njerëzore ndikojnë në shëndet. Kursi do të përqendrohet në përcaktorët shoqërorë dhe në sjelljen e shëndetit, dhe do të përfshijë angazhimin aktiv me mjedisin ndërsa shqyrtojmë shkaqet dhe rrugët për shëndetin dhe sëmundjet.

Specifikisht, moduli synon të rrisë dhe të përmirësojë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet mbi përcaktorët e shëndetit, nëpërmjet:

- Përvetësimit të njohurive bazë mbi përcaktorët socialë dhe të sjelljes së lidhur me shëndetin.
- Kuptimit të rolit që kanë përcaktorët socialë dhe të sjelljes në pabarazitë në shëndet.
- Aftësimit për të identifikuar rolin e çdo përcaktori social dhe të sjelljes në pasojat shëndetësore.

Rezultatet e pritshme

Pas përfundimit të këtij moduli, studentët do të jenë në gjendje:

- Të përcaktojnë termin "përcaktorët socialë dhe të sjelljes të lidhur me shëndetin".
- Të analizojnë, interpretojnë dhe paraqesin të dhëna të bazuara në evidenca mbi përcaktorët socialë dhe të sjelljes së shëndetit.
- Të diskutojnë se si faktorët socialë dhe të sjelljes influencojnë shëndetin, pasojat dhe pabarazitë shëndetësore.
- Të shpjegojnë dallimin midis strategjive të parandalimit të "rrezikut të lartë" dhe "popullatave".
- Të përcaktojnë termin "SES (Socio-Economic_Status) gradient në shëndetësi" dhe të diskutojnë shpjegime alternative për të.

- Të përshkruajnë mekanizmat dhe rrugët përmes të cilave të ardhurat dhe arsimi ndikojnë në rezultatet shëndetësore.
- Të dallojnë ndryshimet midis koncepteve të pabarazisë në të ardhura, privimit absolut dhe atij relativ.
- Të diskutojnë evidencat empirike që lidhin pabarazinë e të ardhurave me shëndetin e popullatës dhe debatet/polemikat në këtë fushë.
- Të analizojnë shembujt e diskriminimit racial në nivele të ndryshme të veprimit (institucional, ndërpersonal, internacional).
- Të përcaktojnë dhe dallojnë konceptet e "rrjeteve sociale" dhe "mbështetjes sociale".
- Të diskutojnë rolin e balancës së punës/jetës në shëndetin e punonjësve.

Lënda 6: Epidemiologji menaxheriale

Pedagogu: Prof. Enver Roshi

Nr. ECTS: 3 (tre)

Përshkrimi i lëndës

Moduli "Epidemiologji menaxheriale" është një kurs i rëndësishëm sepse i njeh studentëtme aspektet kryesore të zbatimit të parimeve epidemiologjike në ofrimin e shërbimeve tëkujdesit shëndetësor dhe menaxhimin e organizatave të kujdesit shëndetësor. Nëkontekstin e administrimit të kujdesit shëndetësor të bazuar në evidencë dhe me qasje nëpopullatë, bëhet kritike të kuptohet ndikimi i sëmundjes në popullatë në një zonë tëcaktuar. Në të njëjtën kohë, ekziston një nevojë në rritje për organizata të kujdesitshëndetësor në nivele të ndryshme për të demonstruar aftësi efektive menaxheriale për t'iu përgjigjur një game të gjerë kërcënimesh shëndetësore duke i menaxhuar ato nëmënyrë efektive dhe në kohën e duhur. Prandaj, drejtuesit e kujdesit shëndetësor duhettë përfshijnë praktikën e epidemiologjisë në funksionet e tyre të ndryshme të menaxhimitduke zbatuar parimet, konceptet dhe metodat epidemiologjike në planifikimin,
vlerësimin dhe menaxhimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor në popullatë.

Objektivat e lëndës

Objektivat e kursit "Epidemiologjia menaxheriale" janë t'u mundësojë studentëve të njohin dhe të kuptojnë parimet dhe konceptet themelore të mëposhtme: orientimi i popullatës në menaxhimin e shëndetit; përdorimi i koncepteve epidemiologjike në planifikimin shëndetësor; zbatimi i metodave epidemiologjike në ofrimin e kujdesit shëndetësor, monitorimi dhe vlerësimi i shërbimeve shëndetësore; standardet dhe cilësia e kujdesit shëndetësor; si dhe çështje që lidhen me minimizimin e kostos dhe menaxhimin efikas të burimeve të disponueshme, përfshirë burimet njerëzore.

Rezultatet e pritshme

- Kuptojnë konceptet kryesore të epidemiologjisë menaxheriale dhe t'i përdorin ato, kur është e përshtatshme, për të: planifikuar, ofruar, monitoruar dhe vlerësuar shërbimet ekujdesit shëndetësor të popullatave;
- Përshkruajnë metodat dhe parimet kryesore të përdorura në epidemiologjinë menaxheriale duke përfshirë orientimin ndaj popullsisë në ofrimin e shërbimeve; mjetet eplanifikimit shëndetësor; mjetet e monitorimit dhe vlerësimit; standardet dhe kriteret ekujdesit shëndetësor, etj;
- Zbatojnë parimet e epidemiologjisë menaxheriale në përputhje me mundësitë praktike,etike dhe ekonomike, për të siguruar ofrimin efektiv dhe në kohë të shërbimeve tëkujdesit shëndetësor;
- Vlerësojnë në mënyrë kritike cilësinë e kujdesit shëndetësor të ofruar në nivelin epopullsisë.

Lënda 7: Menaxhimi i sistemeve të informacionit & monitorim-vlerësimi

Moduli 7.1: Sistemet e informacionit

Pedagogët: Prof. Dr. Kozeta Sevrani
Prof. Asc. Dr. Nevila Baci

Nr. ECTS: 3 (tre)

Përshkrimi i lëndës

Lënda është konceptuar për t'u dhënë studentëve të MPMSH njohuri të përgjithshmenë lidhje me sistemet e informacionit në sitemin shëndetësor, si dhe për të përgatiturprofesionistë të informacionit shëndetësor. Njohuritë e marra gjatë trajtimit të kësaj lëndekanë të bëjnë me konceptet dhe njohuritë bazë në lidhje me sistemet e informacionit nëmenaxhim në një trajtim më të përgjithshëm, si dhe ato të fushës së mjekësisë në veçanti;përcaktimin dhe qëllimin e rekordeve shëndetësore, si dhe format e kontrollit; ruajtjen, përpunimin dhe shpërndarjen e informacionit mjekësor të pacientëve, si dhe çështje qëlidhen me sigurinë, privatësinë, konfidencialitetin dhe ato etike e sociale. Qëllimi i lëndës është t'u ofrojë studentëve gjithashtu një kuptim më të gjerë të sfidave metë cilat përballen drejtuesit dhe menaxherët e shëndetësisë, në përzgjedhjen dhe zbatimine një sistemi informacioni shëndetësor. Lënda është gjithashtu e dizenjuar për të siguruarkontekstin e diskutimit në rritje në lidhje me të dhënat elektronike mjekësore, shkëmbimine informacionit shëndetësor dhe ndikimin e tij në mjediset e brendshme dhe të jashtme që formojnë mjedisin e kujdesit shëndetësor.

Objektivat e lëndës

Objektivat e lëndës janë vendosur në mënyrë që t'u ofrojnë studentëve një kuptim të:

- Rolit të Sistemit të Informacionit /Health Information System (HIS) në organizatat e sotme shëndetësore, në kushtet e globalizmit.
- Sfidave me të cilat përballen drejtuesit dhe menaxherët e kujdesit shëndetësor në lidhje me HIS në mjedise të ndryshme institucionale.
- Zhvillimeve të teknologjive të reja të informacionit në shëndetësi/Health Information Technology (HIT) si robotikë, telemjekësi dhe media sociale, si dhe aplikimet e këtyre teknologjive nga ana e organizatave shëndetësore.
- Sfidave të implementimit të teknologjisë së informacionit shëndetësor.
- Njohjes së mjeteve dhe qasjeve të teknologjive të reja të informacionit që ndihmojnë për të komunikuar në mënyrë efektive me popullatat e ndryshme të pacientëve.
- Sesi përdoren paketat e softuerëve brenda fushës së kujdesit shëndetësor
- Shqyrtimit të çështjeve që lidhen me sigurinë, privatësinë, konfidencialitetin dhe ato etike e sociale.

Rezultatet e pritshme

Në fund të trajtimit të lëndës, studentët duhet të dinë:

- Të zhvillojnë një kuptim më të mirë të çështjeve aktuale dhe të reja në menaxhimin e teknologjisë së informacionit të kujdesit shëndetësor.
- Të përshkruajnë funksionet e përgjithshme, qëllimet dhe përfitimet e sistemeve të informacionit shëndetësor.

• Të demonstrojnë njohuri profesionale në lidhje me menaxhimin e informacionit shëndetësor (Health Information Management (HIM), si dhe për të qenë në gjendje tëpërshtaten me ndryshimet e tyre në mjedisin e kujdesit shëndetësor.
• Të jenë në gjendje të krahasojnë sistemet e informacionit shëndetësor sipas aftësisë së tyre, për të mbështetur kërkesat e një organizate shëndetësore
• Të identifikojnë rolet dhe përgjegjësitë profesionale në menaxhimin e informacionit shëndetësor në zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të të dhënave shëndetësore.
• Të identifikojnë funksionet tipike të kryera nga sistemi i informacionit shëndetësor (HIS).
• Të shpjegojnë ndikimin e të dhënave elektronike të shëndetit në rezultatet e raportimit.
• Të zhvillojnë një kuptim më të mirë të arkitekturës së Teknologjisë së Informacionit (TI) për menaxhimin e informacionit të kujdesit shëndetësor, të propozojnë harduer ,softuer, sistem operativ dhe konsiderata të rrjeteve të nevojshme për ruajtjen dhepërdorimin efektiv të të dhënave në organizatat shëndetësore.
• Të identifikojnë rolin e profesionistit të menaxhimit të informacionit shëndetësor në krijimin dhe mbajtjen e regjistrave elektronikë.
• Të shfrytëzojnë mjetet dhe teknikat për mbledhjen, ruajtjen, sigurimin dhe raportimin e të dhënave të kujdesit shëndetësor.
• Të kuptojnë dhe të zhvillojnë mekanizmat e duhura të matjes së performancës dhe raportimit, për të planifikuar dhe vlerësuar ndikimin e iniciativave të TI-së në mjediset ekujdesit shëndetësor.

Lënda 7: Menaxhimi i sistemeve të informacionit & monitorim-vlerësimi

Moduli 7.2: Monitorim-vlerësimi në shëndetësi

Pedagogu: Dr. Petrit Dollani
Nr. ECTS: 3 (tre)

Përshkrimi i lëndës

Lënda synon të pajisë studentët me njohuri të thelluara bashkëkohore, në drejtim të aspekteve teoriko-praktike që lidhen me monitorimin dhe vlerësimin e programeve nëorganizatat publike, si dhe ato jofitimprurëse. Programi i lëndës përfshin, ndër të tjera,trajtimin dhe sqarimin e koncepteve, të tilla si: kuadri menaxhues i matjes së performancës,procesi i projektimit dhe zbatimit të një sistemi të matjes së performancës, elementet metodologjikë të matjes së performancës, modelet logjike të programeve, matësat objektivë dhe subjektivë të performancës organizative, trajtimet sasiore dhe cilësore të performancës, lidhja ndërmjet performancës individuale kundrejt asaj organizative, menaxhimi i cilësisë, menaxhimi i performancës institucionale etj. Një vend të rëndësishëm zë edhe prezantimi e diskutimi i metodës Balanced Scorecard, duke sugjeruar edhe një aplikim të mundshëm në organizatat shëndetësore. Të gjitha njohuritë e mësipërme bazohen në arritjet më të fundit bashkëkohore në fushën e shkencave menaxhuese dhe përvojat disavjeçare të studimit të këtyre aspekteve në realitetin shqiptar.

Objektivat e lëndës

Objektivat kryesore të kursit janë:

- Kuptimi logjik i koncepteve të thelluara mbi monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe programeve në organizatat publike.
- Analiza e elementeve përbërës të menaxhimit të performancës së programeve.
- Analiza e avancuar e lidhjes së performancës individuale me atë organizative.
- Aftësia për të zbatuar konceptet teorike në raste studimore praktike.

Rezultatet e pritshme

Në përfundim të studimit të kësaj lënde studentët duhet të jetë në gjendje:

- Të përdorin në mënyrë racionale teknikat menaxhuese në funksion të përmirësimit të performancës së shërbimeve shëndetësore.
- Të zotërojnë njohuritë e duhura teorike dhe aftësitë praktike mbi metodat e monitorimit dhe vlerësimit të programeve në organizatat publike.
- Të monitorojnë dhe të vlerësojnë në mënyrë të pavarur programe shëndetësore publike.
- Të kenë vizionin e duhur të administratorit publik, dhe të mund të marrin përsipër detyra drejtuese në nivel të mesëm në organizata publike shëndetësore.

Lënda 8: Lidership dhe aftësi komunikimi

Moduli 8.1: Lidership

Pedagogu: Dr. Gentian Shaqiri
Nr. ECTS: 3 (tre)

Përshkrimi i modulit

Lënda e lidershipit i njeh studentët me konceptet themelore të lidershipit në mjedisin e sotëm dinamik dhe me shkallë të lartë ndryshimi. Ajo e vë theksin tek elementet kryesorë procesit udhëheqës në organizatat moderne. Një aspekt kritik i rëndësishëm i këtij cikli leksionesh është se gjatë trajtimit të lidershipit mbështetemi në disiplina të ndryshme, porasnjëra prej tyre nuk mund të përcaktojë e vetme setin e presupozimeve bazë. Duke e parë lidershipin me lente të ndryshme, i përqasemi më mirë kuptimit të thelbit të tij, dhe kështu bëhemi më të aftë për ta praktikuar atë në kontekste të ndryshme. Ky kurs i ri është projektuar për studentët e programit master në menaxhim shëndetësor, duke përfshirë studentët e diplomuar, stazhierët, drejtuesit aktualë ose të ardhshëm, si dhe aktorë të tjerë me interes të përgjithshëm në lëndën e lidershipit. Nuk pritet ose nuk është e nevojshme asnjë përvojë e mëparshme ose formim i domosdoshëm akademik për të patur rezultatetë mira në kurs. Sesionet e orëve do të jenë një kombinim i prezantimeve/leksioneve, çështjes dhe diskutimit të temave dhe shpjegimeve të synuara për demonstrimin e një parimi në veprim. Gjatë gjithë kursit do të fokusohemi në vlerësimin e efektivitetit të roleve dhe përgjegjësive të liderit, duke kuptuar avantazhet dhe disavantazhet, duke njohur implikimet e sjelljeve dhe veprimeve, dhe duke zhvilluar aftësitë për trajtimin e situatave të vështira gjatë drejtimit. Lidershipi në vetvete është kontekstual, kërkon vlerësim dhe gjykim të kushteve rrethanore.

Objektivat e modulit

Objektivat kryesore të kursit janë:

- Të pajisë studentët me njohuri të specializuara mbi konceptet bazë të lidershipit, si dhe kontributin e këndvështrimeve nga shkenca të ndryshme në përgatitjen adekuate të tyre.
- Të analizojë rolin e menaxherit në pozicionin e liderit, si dhe raportet respektive ndërmjet këtyre nocioneve të rëndësishme.
- Të orientojë studentët të zhvillojnë aftësi në aplikimin e teorive të lidershipit, të motivimit apo të mjedisit multikulturor të forcës së sotme të punës.
- Ta aftësojë studentët që të zhvillojnë aftësitë kritike për të analizuar rëndësinë dhe aplikimin praktik të komunikimit, ndryshimin organizativ dhe veçoritë përkatëse të lidershipit në mjedise të ndryshme.

Rezultatet e pritshme

Në përfundim të studimit të kësaj lënde studentët duhet të jenë në gjendje:

- Të kenë përvetësuar konceptet bazë të lidershipit.
- Të përdorin aspekte të teorisë së lidershipit sipas specifikave të mjedisit në fushën e shëndetit.
- Të realizojnë praktikisht motivim të diferencuar të stafit në mjedisin e punës.
- Të dinë të aplikojnë stile lidershipi sipas situatave dhe diferencave që parashtron mjedisi shëndetësor.

Lënda 8: Lidership dhe aftësi komunikimi

Moduli 8.2: Aftësi komunikimi

Pedagogu: Dr. Fatma Jaupi

Nr. ECTS: 3 (tre)

Përshkrimi i modulit

Lënda synon të zhvillojë aftësitë e studentëve për të komunikuar në mënyrë efektive në çdo situatë që lidhet me aktivitetin e tyre profesional. Në mënyrë të veçantë synohet të zhvillohen aftësitë e tyre komunikuese ndërpersonale, si dhe në grup. Në këtë lëndë theksohet aspekti praktik dhe synohet përgatitja e individëve të aftë, që të përballen me realitetin e tregut të punës. Komunikimi është një koncept shumë i rëndësishëm në organizatë, dhe aftësia për të komunikuar efektivisht është një faktor kyç në arritjen e suksesit. Kjo lëndë merr në shqyrtim mjetet nëpërmjet të cilave komunikojnë individët dhe organizatat, duke treguar se si ato mund të shfrytëzohen në mënyrë efektive. Përmbajtja e lëndës përfshin: mënyrat e ndërtimit të mesazheve efektive, kontekstin profesional, kulturor dhe social të komunikimit, stimulimin e vullnetit të mirë në komunikim, analizën e komunikimit me shkrim, aftësitë komunikuese ndërpersonale, përgatitjen vizuale të prezantimeve, si dhe një numër të madh rastesh studimore

Objektivat e modulit

- Përftimi i njohurive bashkëkohore mbi komunikimin me shkrim.
- Kuptimi i rëndësisë së komunikimit në kontekstin organizativ bashkëkohor.
- Familjarizimi me konceptet, termat bazë të komunikimit dhe mënyrat e duhura të përdorimit të tyre.
- Aftësimi për zgjedhjen e mjeteve të përshtatshme komunikuese, në varësi të situatave konkrete në organizatë.
- Përvetësimi i metodave komunikuese që çojnë në performancë të lartë të punës në grup.
- Aftësimi për përgatitjen e prezantimeve verbale të suksesshme me ndihmën e mjeteve vizuale elektronike.

Rezultatet e pritshme

Në përfundim të studimit të kësaj lënde studentët duhet të jenë në gjendje:

- Të hartojnë mesazhe efektive verbale, me shkrim dhe elektronike.
- Të përdorin të dëgjuarin efektiv dhe të përmirësojnë aftësitë e punës në grup.
- Të marrin pjesë në hartimin e raporteve apo planeve të thjeshta organizative.
- Të ndërtojnë dhe të realizojnë prezantime efektive, me mjete multimediale.
- Të realizojnë komunikimin e duhur me stakeholders.

Lënda 9: Organizimi i sistemit shëndetësor

Pedagogu: Prof. Asc. Qamil Dika

Nr. ECTS: 5 (pesë)

Përshkrimi i lëndës

Mënyra sesi organizohet sistemi shëndetësor i një vendi të caktuar varet nga një sërë rrethanash dhe traditash historike, kulturore, politike, ekonomike dhe sociale. Katëra ktorët kryesorë në çdo sistem shëndetësor përfshijnë: qeverinë, ofruesit e shërbimeve shëndetësore, klientët/pacientët dhe siguruesit shëndetësorë. Kombinimi i caktuari këtyre aktorëve u jep jetë sistemeve klasike të sistemit shëndetësor që njohim sot, si dhe formave hibride apo eksperimentale të sistemeve shëndetësore kudo në botë. Lënda "Organizimi shëndetësor" synon të përshkruajë me detaje katër aktorët kryesorë në çdo sistem shëndetësor, duke hedhur dritë mbi mekanizmat, mbi bazën e të cilave janë krijuar modelet e sistemeve shëndetësore në vende të ndryshme, si dhe një analizë të mirëfilltë të forcave që kanë krijuar dhe vazhdojnë të krijojnë dhe të formëzojnë sistemin shëndetësor të vendit tonë.

Objektivat e lëndës

Objektivi kryesor i lëndës së organizimit shëndetësor është thellimi i njohurive në fushën e organizimit të sistemit shëndetësor të një vendi, duke përfshirë këtu institucionet, personelin, mekanizmat dhe veprimtaritë e nevojshme me të cilat sigurohet: prodhimi dhe forcimi i vazhdueshëm i shëndetit të popullatës, mbrojtja e shëndetit nga faktorët rrezikues e dëmtues, parandalimi i sëmundjeve, diagnoza e hershme e tyre tek individët e prekur, mjekimi i përshtatshëm, rehabilitimi, riaftësimi i individëve të sëmurë dhe kujdesi ndaj personave të paaftë shëndetërisht.

Rezultatet e pritshme

Në fund të modulit, studentët duhet të jenë të aftë:

- Të përshkruajnë aktorët kryesorë të sistemit shëndetësor.
- Të përshkruajnë dhe të dallojnë llojet bazë të organizimit të sistemeve shëndetësore në botë.
- Të përshkruajnë dhe të njohin karakteristikat dalluese të modeleve të ndryshme të sistemeve shendetësore.
- Të kuptojnë rolin e qeverisë në modelin shëndetësor të një vendi.
- Të kuptojnë rolin e ofruesve të shërbimeve shëndetësore në modelin shëndetësor të një vendi.
- Të kuptojnë rolin e klientëve/pacientëve në modelin shëndetësor të një vendi.
- Të kuptojnë kuptojnë rolin e siguruesve shëndetësorë në modelin shëndetësor të një vendi.
- Të vlerësojnë në mënyrë kritike sistemin shëndetësor të një vendi të caktuar dhe faktorët që përcaktojnë të tashmen dhe të ardhmen e këtij sistemi.

Lënda 10: Menaxhimi i burimeve njerëzore

Pedagogët: Dr. Martin Serreqi

Nr. ECTS: 5 (pesë)

Përshkrimi i lëndës

Lënda synon të pajisë studentët me njohuri të thelluara bashkëkohore, në drejtim të aspekteve teoriko-praktike që lidhen me menaxhimin e burimeve njerëzore (MBNJ) në një institucion të kujdesit shëndetësor. Programi i lëndës përfshin, ndër të tjera, trajtimin dhe sqarimin e praktikave të tilla si: organizimi dhe planifikimi i punës në organizatat e kujdesit shëndetësor, rekrutimi dhe seleksionimi i punonjësve, trajnimi dhe zhvillimi i punonjësve, menaxhimi i performancës dhe praktikat e shpërblimit, marrëdhëniet e punës dhe shëndeti, si dhe siguria e punonjësve në punë.

Kjo lëndë është konceptuar për të pajisur me njohuri dhe disa aftësi praktike në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore, të gjithë ata që synojnë jo vetëm një pozicon specialisti apo menaxheri në burimet njerëzore, por edhe pozicionin e menaxherit të përgjithshëm në industrinë e kujdesit shëndetësor.

Objektivat e lëndës

- T'u japë studentëve konceptet dhe njohuritë për menaxhimin e burimeve njerëzore.
- Të njohë studentët me proceset, praktikat dhe sistemet që përfshihen kur organizatat synojnë të punësojnë, mbajnë dhe motivojnë burimet njerëzore.
- Të prezantojë studentët me parime e vendime në fusha të ndryshme të MBNJ.
- Të aftësojë studentët për të bërë analiza lidhur me politikat dhe praktikat e burimeve njerëzore në një organizatë, dhe për të dhënë mendime lidhur me përmirësimin e tyre.

Rezultatet e pritshme

Në përfundim të kursit, studentët:

- Do të jenë të aftë të evidentojnë rëndësinë e menaxhimit të një prej burimeve më të rëndësishme të organizatës, burimeve njerëzore.
- Do të pajisen me njohuri për funksionin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe të kuptojnë rolin e funksionit të MBNJ-së në organizatë.
- Do të evidentojnë funksionet, praktikat dhe politikat që përfshihen në MBNJ.
- Do të realizojnë analiza kritike të problemeve dhe sfidave bashkëkohore të praktikave dhe politikave të MBNJ-së.
- Do të përmirësojnë aftësitë e prezantimit të punëve individuale dhe në grup.

Lënda 11: Praktikë

Pedagogu: Prof. Asc. Ervin Toçi

Nr. ECTS: 4 (katër)

Përshkrimi i lëndës

Qëllimi i kësaj lënde është tu sigurojë studentëve mundësi konkrete që të realizojnë praktikën mësimore në një organizatë shëndetësore duke filluar nga planifikimi i praktikës deri në realizimin dhe dokumentimin e kësaj eksperience duke përdorur njohuritë e fituara në lëndët teorike në realitetin e organizatave shëndetësore. Kjo Lëndë kontribuon që studenti të fitojë nivelin e aftësive profesionale që programi i MMSH parashikon. Me këtë lëndë studentët aftësohen si të hartojnë Projektin e praktikës mësimore bazuar nëzhvillimin e kompetencave për fushën/aspektet e menaxhimit shëndetësor me interes për ta, dhe si të mbledhin, analizojnë eksperiencën e dokumentuar të praktikës në Ditarin e Praktikës në një Raport që mund të shërbejë gjithashtu si bazë për hartimin e Tezës së masterit. Në këtë lëndë, studentët do të kalojnë gjithsej 4 javë (100 orë) në një organizatë shëndetësore të përzgjedhur, duke kombinuar punën individuale të tyre me mbikqyrjen nga Mbikqyrësi i praktikës nëorganizatën bujtëse, me takimet periodike me Pedagogun me përgjegjës për praktikat dhe komunikimin me Koordinatorin e praktikave.

Rezultatet e të nxënit

Në përfundim të këtij kursi, studenti është në gjendje:

- Të përshkruajë çështje të menaxhimit shëndetësor që lidhen me projektin e tij (problematika, situata, nevojat) dhe të shpjegojë se përse projekti karakterizohet si i tillë në fushën e menaxhimit shëndetësor (duke ju referuar aspekteve konkrete të menaxhimit shëndetësor).
- Të identifikojë cilat pritshmëri dhe nevoja të organizatës shëndetësore do të plotësojë ai me Raportin e tij dhe të komentojë se si propozimi i tij për këtë praktikë do të jetë në përgjigje të këtyre pritshmërive dhe/ose nevojave.
- Të bëjë një vlerësim të situatës së problematikës të synuar nga praktika mësimore. Për këtë, studenti është në gjendje të:
  - të identifikojë burime informacioni të besueshme dhe të përshtatshme, përfshirë dhe rishikimin e literaturës;
  - të interpretojë informacionin duke konsideruar konteksin politik, ekonomik, socio-kulturor, etik, dhe shkencor në nivel kombëtar dhe lokal
- Të zhvillojë një plan zbatimi ose analize duke përdorur metoda të përshtatshme për të adresuar problematikën e synuar. Ky plan zbatimi përfshin çështjet metodologjike dhe nevojat/mangësitë dhe çështjet specifike të organizatës, zbatimin, përshtatjet e mundshme gjatë zbatimit dhe vlerësimin e zbatimit të praktikës së tij.
- Të hartojë Raportin e praktikës dhe të përfshijë në të një ose disa rekomandime operacionale për organizatën ku ka bërë praktikën në lidhje me mandatin/detyrën e praktikës.
- Të ndajë rezultatet e praktikës të tij me individë, partnerë, donatorë dhe kolegë. Studenti duhet të përshtasë prezantimin e rezultateve në varësi të audiencës (profesionistë dhe jo-profesionistë; partnerë, donatorë etj).
- Të bëjë një analizë kritike mbi praktikën e tij/e saj mësimore duke mbajtur në konsideratë çështje që janë me rëndësi në fushën e menaxhimit shëndetësor.

Aneksi 1: Plani mësimor i programit të studimit "Master Profesional në Menaxhim Shëndetësor"

Plani mësimor i programit të studimit të ciklit të II-të: **Master Profesional në Menaxhim Shëndetësor**
Viti akademik **2021-2022**

Forma e studimit: **Me kohë të plotë**

Veprimtaritë formuese: A(3-6), B(18-24), C(12-18), D(6), E(6-12), A+B >30 ECTS			
Orë mësimore/ 1 ECTS			
L	S	U	Dipl.
10	7.5	15	5

Kod Lënda	Nr	Lëndët	Ngarkesa e lëndëve / veprimtarive formuese								Ngarkesa javore			Sem kur zhvillohet lënda
			A-E	ECTS	Orë gjithsej me auditor	Leksione	Seminar	Ushtrime	Praktikë	Orë gjithsej jashtë auditor	Leksione	Seminar	Ushtrime	
MP-G 101	**1**	**EKONOMI SHËNDETI**	**B**	**5**	**60**	**30**		**30**		**65**	**2**		**2**	**I**
MP-G 102	**2**	**MENAXHIM SHËNDETËSOR**	**A**	**6**	**60**	**30**	**15**	**15**		**90**	**2**	**1**	**1**	**I**
MP-G 103	**3**	**STATISTIKË**	**B**	**5**	**60**	**30**		**30**		**65**	**2**		**2**	**I**
MP-G 104	**4**	**FINANCA DHE KONTABILITETI I KUJDESIT SHËNDETËSOR**	**B**	**5**	**60**	**30**		**30**		**65**	**2**		**2**	**I**
MP-G 104A	*4.1*	*Financa në kujdes shëndetesor*		*2.5*	*30*	*15*		15		32.5	*1*		*1*	
MP-G 104B	*4.2*	*Kontabilitet në kujdes shëndetësor*		*2.5*	*30*	*15*		15		32.5	*1*		*1*	
MP-G 105	**5**	**PËRCAKTUESIT SOCIALË DHE MJEDISORË TË SHËNDETIT**	**B**	**6**	**75**	**30**		**45**		**75**	**2**		**3**	**I**
MP-G 105A	*5.1*	*Shëndet mjedisor*		*3*	*37.5*	*15*		22.5		37.5	*1*		*1.5*	
MP-G 105B	*5.2*	*Përcaktuesit social dhe të sjelljes në shëndetësi*		*3*	*37.5*	*15*		22.5		37.5	*1*		*1.5*	
MP-G 106	**6**	**EPIDEMIOLOGJIA MENAXHERIALE**	**C**	**3**	**37.5**	**15**		**22.5**		**37.5**	**1**		**1.5**	**I**
MP-G 112	**7**	**MENAXHIMI I SI NË SHËNDETËSI &MONITORIMI DHE VLERËSIMI**	**C**	**6**	**75**	**30**		**45**		**75**	**2**		**3**	**II**
MP-G 107	*7.1*	*Menaxhimi i sistemeve të informacionit në shëndetësi*		*3*	*37.5*	*15*		22.5		37.5	*1*		*1.5*	
MP-G 107B	*7.2*	*Monitorimi dhe vlerësimi*		*3*	*37.5*	*15*		22.5		37.5	*1*		*1.5*	
MP-G 108	**8**	**LIDERSHIP DHE AFTËSI KOMUNIKIMI**	**C**	**6**	**75**	**30**		**45**		**75**	**2**		**3**	**II**
MP-G 108A	*8.1*	*Lidership*		*3*	*37.5*	*15*		22.5		37.5	*1*		*1.5*	
MP-G 108B	*8.2*	*Aftësi Komunikimi*		*3*	*37.5*	*15*		22.5		37.5	*1*		*1.5*	
MP-G 109	**9**	**ORGANIZIMI I SISTEMIT SHËNDETËSOR**	**B**	**5**	**60**	**30**		**30**		**65**	**2**		**2**	**II**
MP-G 113	**10**	**MENAXHIM I BURIMEVE NJËRËZORE**	**C**	**5**	**60**	**30**		**30**		**65**	**2**		**2**	**II**
MP-G 114	**11**	**PRAKTIKE**	**D**	**4**	**100**				**100**	**0**				
MP-G 111	**12**	**TEME DIPLOME**	**E**	**4**	**20**	**20 orë */20 hrs**				**80**	**20 orë/ 20 hrs**			**II**
		Total		**60**	**742.5**	**285**	**15**	**322.5**	**100**	**757.5**				

Pergjegjësi i Departamentit **Dekani**

Gentiana Qirjako **Xheladin DRAÇINI**

Ky publikim dhe programi i Masterit në Menaxhim Shëndetësor janë mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC nëpërmjet projektit të saj Shëndet për të Gjithë (HAP)

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

HAP
health for all project